

VENDIM
Nr. 614, datë 24.7.2013

**PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJES SË TË NDJERIT SELMAN HAJREDIN
LENA, ISH- PUNONJËS POLICIE, RËNË NË KRYE TË DETYRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrisë të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e ndihmës financiare prej 4 000 000 (katër milionë) lekësh familjes së të ndjerit Selman Hajredin Lena, ish-punonjësi policie në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë, i cili humbi jetën në krye të detyrës.
2. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2013, programi “Policia e Shtetit”, miratuar për Ministrinë e Brendshme.
3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha